



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2019:092506  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05642965

C.nr.445/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.H. nga P. të cilin e përfaqëson Mustafë Kastrati avokat në Pejë, kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh. A. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E.A. jurist në kompani, me bazë juridike anulim i vendimeve dhe kompensim i pagave, vlera e kontestit 3,290.39 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse dhe të autorizuarit të paditurës, me datë 18.04.2024 mori, kurse me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.H. nga P. kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh. A. me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHEN si të kundërligjshëm vendimi i të paditurës me numër 01-7../18 i datës 06.04.2018 mbi largimin e përkohshëm nga puna të paditësit dhe vendimi i të paditurës me numër 01-21../18 dt.16.10.2018 mbi ri sistemimin e paditësit nga vendi i punës si kontrollor i zyrës postare në Pejë në vendin e punës punëtor sporteli – Regjioni Pejë.
- III. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të kompensimit të 50 % të pagave të pa paguara nga data 06.04.2018 e deri me datën 16.10.2018 të ia paguajë shumën dhe atë: në emër të diferencës së pagës neto prej 1,901.37 euro, në emër të kontributeve për trustin pensional në shumë totale prej: 222.38 euro, ku 111,19 euro do të paguhen si kontribut i punëdhënësit (paditurit) të llogaritur 5%, kurse 111,19 euro do të paguhen si kontribut i punëmarrësit (paditësit) e të cilat do të paguhen në llogarinë e paditësit në Trustin Pensional – Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në emër

të tatimit në pagë në shumë: 211,26 euro të cilat do të paguhen si tatim në burim në ATK, me kamatë të llogaritur nga data 01.05.2018 e deri me datën 10.09.2018 në shumën prej 171,39 euro, dhe në emër të diferencës në mes të gradës 6 dhe 5 për periudhën nga data 06.10.2018 e deri me datën 05.10.2019 në lartësi të pagës neto prej 777,96 euro, në emër të kontributeve për trustin pensional në shumë totale prej: 90,98 euro, ku 45,49 euro do të paguhen si kontribut i punëdhënësit (paditurit) të llogaritur 5%, kurse 45,49 euro do të paguhen si kontribut i punëmarrësit (paditësit) e të cilat do të paguhen në llogarinë e paditësit në Trustin Pensional – Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në emër të tatimit në pagë në shumë: 86,44 euro të cilat do të paguhen si tatim në burim në ATK, me kamatë të llogaritur nga data 01.11.2018 e deri me datën 10.09.2019 në shumën prej 26,33 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

- IV. DETYROHET e paditura për pjesën tjetër të kamatës ligjore prej 8% në vit e cila do të rrjedhë për pagesë për diferencën e pagave të papaguara pas datës 16.10.2018 dhe për diferencën në mes të gradës 6 dhe 5 pas datës 05.10.2019 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto (nga pika III e këtij dispozitivi) në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.
- V. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale, të ia paguajë shumën prej 1,054 euro në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

#### Arsyetim

##### I. Historiku i procedurës

Paditësi I.H. nga P. të cilin e përfaqëson Mustafë Kastrati avokat në Pejë, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh. A. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E.A. jurist në kompani, ka ngritur padi me bazë juridike anulim i vendimeve dhe kompensim i pagave, vlera e kontestit 3,290.39 euro.

Gjykata e titullit, me aktgjykimin e datës 12.12.2019, ka aprovuar në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e palës paditëse, duke anuluar si të kundërligjshëm vendimet e atakuar, si dhe duke i njohur palës paditëse kompensimin e pagave të pa paguara.

Gjykata e apelit, me aktvendimin AC.nr.51../20 te datës 24.01.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës së paditur, ka prishur aktgjykimin e gjykatës së titullit dhe lëndën ia ka kthyer të njëjtës gjykatës në rigjykim dhe vendosje.

## II. Pretendimet e ndërgjyqësve

I autorizuari i paditësit në rigjykim, ka qëndruar në tërësi pranë padisë initiale, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën të aprovohet në tërësi si e bazuar, kurse gjatë seancave ka deklaruar se paditësit pa bazë ligjore i është shqiptuar masa e suspendimit të përkohshëm prej 6 muajsh dhe ri sistemimi dhe degradimi në pozitë në bazë të vendimit të dt. 16.10.2018 dhe atë për një vit. Vendimi mbi suspendim dhe ri sistemim është në kundërshtim të plotës me kontratën e punës së paditësit dhe detyrat e përgjegjësitë që i ka në bazë të kontratës dhe në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës te të paditurës si dhe në kundërshtim me aktvendimin e PTH në Pejë PP.II.nr. 21../18 i dt. 12.11.2018 me të cilën është hedhur kallëzimi penale ndaj paditësit, rrjedhimisht kur nuk ka vepër penale nuk ka as dëm të shkakuar. Se paditësi ka qenë punëtor me integritet dhe profesionalizëm kjo është vërtetuar me rikthimin e tij në pozën në të cilën ka qenë pas dt. 05.10.2019. lidhur me kërkesën të cilën e kemi ushtuar paraqitet e domosdoshme që e njëjta të rregullohet për shkak se i njëjti është kthyer në pozitën në të cilën e kaënë andaj kërkesëpadia e dt. 22.11.2018 precizohet ashtu që paragrafi 4 ku ceket se obligohet që ta kthej në pozitën në të cilën ka qenë tërhiqet si kërkesë pasi që i njëjti është kthyer në vendin e punës në të cilën ka qenë, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbetet pa ndryshuar. Mirëpo ne as pala paditëse nuk posedon vendimin mbi kthimin e vendin e punës në të cilin ka qenë dhe deri me sot edhe pse i njëjti e ushtron atë pozitë asnjëherë nuk i është dorëzuar, kërkoj nga gjykata që një vendim të tillë ta obligoj palën e paditur ta sjellë, ndërsa lidhjet me shkeljet që pretendon pala e paditur që i ka kryer paditësi të njëjta nuk qëndron pasi që i njëjti nuk ka qenë i ngarkuar me pozitën e arkëtarit e as financierit por ka qenë me pozitën e kontrollorit dhe pala paditur pa bazë ligjore e ka ngarkuar paditësin dhe degraduar në pozitë vetëm për faktin se i njëjti ditën kritike ka qenë në zyre me kolegun Q.A. e ku në atë zyre gjendeshin paratë, e të cilat para kolegu Q.A. ka qenë i ngarkuar atë ditë që ti menaxhoj. Po ashtu ka munguar incizimi i kamerave ditën kritike ku do të shihej se kush ka hy në zyrë, kush i ka marrë ato para dhe kush ka dal nga zyra me ato para. Për ne është vendimi pa ligjshëm pasi që akuzat që e paditura i ka bërë paditësit bie ndesh, e detyrat e punës që i ka pala paditëse dhe me asnjë

vendimi të vetëm e paditura nuk ka arritur të argumentoj faktin se i njëjti ka qenë i ngarkuar me menaxhimin e mjeteve financiare në arkë, bazuar në lartcekurat konsiderojmë se procedura disiplinore është zhvilluar pa bazë ligjore në raport me paditësin. Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka theksuar Me administrimin e provave në tërësi është vërtetuar baza dhe lartësia e kërkesëpadisë andaj gjykatës i propozojmë që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar në precizimin e dt. 18.09.2019 dhe 18.03.2024. Me këtë rast lidhur me kërkesëpadinë kemi dhënë edhe sqarime të duhura me parashtresën e dt. 05.04.2024 kurse sqarojmë se për masën disiplinore e njëjta ka qenë e pa bazuar që nga fillimi sepse paditësi asnjëherë në formë të shkruar nuk ka qenë i ngarkuar me arkë pra nuk ka pas kontratë pune për atë vend pune apo vendim të shkruar fakte këto që janë konfirmuar me vendimin penal.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në lartësi prej 1.592,00 euro.

I autorizuari i palës së paditurës, në rigjykim ka qëndruar në tërësi pranë pretendimeve të dhëna si në përgjigje në padi dhe deklarimeve e në seancat e kaluara në të cilat kemi argumentuar në mënyrë të plotë dhe të sakët se kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë juridike për aprovim të njëjtës i mungon baza ligjore se si e tillë nuk është e mbështetur me asnjë provë materiale që sot të vërtetonin pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit numër 01-2... dt. 16.10.2018. E njoftojmë gjykatën se kemi pranuar aktvendimin e gjykatës së apelit AC nr. .../20 i cili aktvendim është obligator si për gjykatën ashtu edhe për palët ndërgjyqëse prandaj kërkojmë nga gjata që në ri shqyrtim të kësaj çështje kontestimore ti eliminoj vërejtjet e theksuara aktvendim dhe pas administrimit e provave kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. S i përket pretendimeve e të paditësit se kallëzimi penale për çështjen e punëtorë I.H. është hedhur poshtë e njoftojmë palën paditëse se veprimet apo mos veprimet e punëtorit mund të përbëjnë shkelje disiplinore dhe të njëjtat mos të përbëjnë për penale. Andaj fakti se paditësi është liruar nga përgjegjësia penale nuk nënkupton se i njëjti nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore dhe në rastin konkret paditësit është shpallë përgjegjës nga Komisioni disiplinor me vendimin numër 01-1.../18 dr. 24.05.2018 e cila masë është shqiptuar konform kodit të mirësjelljes dhe të gjeturave e nga raporti i inspektoratit postar lidhur me mungesën e shumës prej 6,244.00 euro. E paditura tërë procedurën e gjertanishme ka theksuar se gjerë të largimi i përkohshëm nga puna e paditësit dhe ri sistemimi i tij në një vend tjetër të punës ka ardhur për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtarë sipas të cilës është konstatuar mungesa e mjeteve financiare në arkën ndihmëse sipas shumës së cekur më lartë. Mungesën e konstatuar e ka pohuar edhe e vetë paditësi dhe është vërtetuar edhe nga raporti i inspektorëve postar i

cili ka bërë përgjegjës për këtë mungesë paditësin pasi që i njëjti së bashku me kolegun tjetër Q.A. kanë qenë të ngarkuar me mjetet financiare dhe përgjegjës për mbajtjen e çelësave të kasafortës kanë punuar në një hapësirë në zyrë të përbashkët ku ka qenë e vendosur edhe kasaforta dhe mbi të gjitha të njëjtit e kanë menaxhuar me mjetet financiarë dhe produktet që kanë qenë në kasafortë duke bërë ngarkimin dhe shkarkimin e punëtorëve sportelista me produkte dhe mjete financiare. Përveç tjerash për mungesën e konstatuar ndaj paditësit është iniciuar procedurë disiplinore, gjatë zhvillimit të procedurës komisioni disiplinor e vendimin e dt. 24.05.2018 ka konstatuar se paditësi është përgjegjës për shkak se në veprimet e tija ka bërë shkelje serioze të detyrave të punës të përcaktuara me kodin e mirësjelljes kështu që i ka rekomanduar resurseve njerëzore që paditësin në momentin e kthimit në punë ta sistemoj në pozitë me të ulët ku do të kishte përgjegjësi dhe pagë me të vogël. E paditura mendon se në anenë saj nuk ka kurrfarë përgjegjësie nga e cila do të linte obligimi për kompensimin e të rrudhurave personale për largimin e përkohshëm nga puna si dhe kompensimin e ndryshimit të pagës nga koeficienti 5 në 6 si dhe kthimi në vendin e mëparshëm i punës në pozitën kontrollor i zyrës postare, duke e anuluar njëkohësisht vendimin mbi në ri sistemi të apostrofuuar më lart, me çka i propozojmë gjykatës që pas eliminimit dhe vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit me çka do ta refuzonte kërkesëpadinë e paditësit. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e paditura vlerëson se ka argumentuar në mënyrë të plotë dhe të sakët se kërkesëpadia e paditësit nuk ka mbështetje ligjore dhe nuk është mbështetur me prova materiale që do të vërtetoni pretendimet e paditësit të pretenduara në padi. Edhe njëherë ritheksojmë se deri te largimi i përkohshëm nga puna si dhe risistemimi në vend tjetër të punës për periudhën 06.10.2018 deri 05.10.2019 ka ardhur për shkak të neglizhencës dhe pakujdesisë së kryerjes së detyrave të punës dhe si rezultat i saj e paditura ka pësuar një dëm në vlerë prej 6,244.00 euro, mjete me të cilat ka qenë i ngarkuar paditësi. Përveç tjerash për mungesën e konstatuar ndaj paditësit është iniciuar procedura disiplinore dhe gjatë zhvillimit të kësaj procedurë komisioni disiplinor me vendim ka konstatuar se paditësi është përgjegjës për shkak se me veprimet e tija ka bërë shkelje serioze të detyrave të punës të përcaktuara me kodin e mirësjelljes së punëtorëve të postës dhe i ka rekomanduar resurse njerëzore që paditësin ta risistemoj në një pozitë me të ulët ku do të ketë pagën dhe përgjegjësinë me të vogël. Si rezultat i keqpërdorimit të detyrë zyrtare nga ana e paditësit dhe mungesës së mjeteve financiare në arkën ndihmëse e paditura shihet se ka risistemuar paditësin në vendin tjetër të punës si punëtor sporteli me të ardhura personale sipas gradës 5 gjithmonë duke respektuar në tërësi dispozitat e nenit 73 par 1.3 të ligjit të punës, nenit 15 pika 4 e kodit të mirësjelljes së punonjësve dhe procedurave disiplinore numër 01-1481/17 si dhe neni 23 par 1.3 të aktit të brendshëm

konkretisht rregullores për rregullimin e marrëdhënies së punës për punëtorët e postës së Kosovës numër 01-2456/17 në këtë kuptim e paditura mendon se në anën e saj nuk ka kurrfarë përgjegjësia nga e cila do të linte obligimin për kompensimin e të ardhurave personale për paditësin për periudhën e largimit ë përkohshëm nga puna si dhe kompensimin e ndryshmit të pagës nga koeficienti 5 në 6 duke anuluar vendimin e largimit të përkohshëm 01-791/18 si dhe vendimin mbi ri sistemim numër 01-2176/18, me çka i propozojmë gjykatës që pas shqyrtimit të përgjigjes në padi , administrimit të provave materiale, thënieve të deklaruara në seanca te gjertanishme , fjalës përfundimtare dhe dispozitave e ligjore të lartcekura e duke ju përmbajtur edhe rekomandimeve të theksuara me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AC nr. 519/20 të nxjerrë aktgjykime të cilën refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në lartësi prej 1.215,00 euro.

### III. Provat e administruara nga gjykata

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, sipas propozimit të palëve, në procedurën e të provuarit, i ka administruar këto prova: Kontrata e punës për kohë të pacaktuar me numër ../2013 e dt. 20.03.2013, vendimi mbi largimin e përkohshëm të punëtorit nga kompania e PK sh.a. me numër 01-../2018 i datës 06.04.2018, Përgjigja e datës 25.04.2018 me numër 01-..9/18 e Postës së Kosovës sh.a., Aktvendimi me numër PP/II.nr.2...2018 i dt.12.11.2018 i Prokurorisë Themelore në Pejë, Vendimi mbi risistemimin e punëtorit me numër 01-2.../18 i datës 16.10.2018, ankesa e dt. 26.10.2018 e ushtruar kundër vendimit mbi risistemimin e punëtorit I.H., Raporti i Inspektoratit të punës i datës 18.12.2018 me numër 2.., raporti nga sistemi i automatizimit të sporteleve të Postës së Kosovës për datën 05.04.2018 e tutje, vërejtja verbale me shkrim i datës 30.03.2018 për punëtorin I.H., Deklarata e I.H. e dt. 06.04.2018, Deklarata e Q.A. e dt. 06.04.2018, Deklarata e N.K. e dt. 06.04.2018, Deklarata e R.G. e dt. 06.04.2018, tri fotografi në bardh e zi të disa dosjeve dhe një sefi, Raporti për paraqitje në Komision Disiplinor për I.H. nr. 03- ../2018 dt. 13.04.2018, vendimi i komisionit disiplinor i dt. 24.05.2018 nr. ....0/18, Raporti i inspektimit lidhur me mungesën e mjeteve financiare në arkën e ZP Pejë 1 protokoli 01-../18 dt.16.04.2018, të dhënat për koeficientin 5 dhe 6 për paditësin I.H., Ekspertiza financiare e ekspertit Gani Gashi e dt. 11.09.2019, email-at

e dt. 30.9.2019, 30.9.2019 , 22.10.2018, 17.10.2018, 16.10.2018, 15.10.2018,15.10.2018, 15.10.2018,15.10.201, si dhe është dëgjuar paditësi në cilësi të palës në shqyrtimin C.nr.../18.

#### IV. Vlerësimi faktik dhe juridik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse, tek e paditura ka qenë i punësuar në pozitën kontrollor i zyrës postare në (Pejë 01), me kontratë me afat të pa caktuar.

Kontestues nuk ishte fakti se pala paditëse kishte marrë vendimin për largimin e përkohshëm nga puna për paditësin dhe për sistemimin e të njëjtit, për çka edhe është zhvilluar kontesti.

Rezultoj të mos jetë kontestues fakti se paditësi është kthyer në vendin e tij të punës, të cilin e ka pas para se të largohet përkohësisht nga puna, të cilin fakt e kanë pohuar të autorizuarit e ndërgjyqësve.

Kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse ishte fakti nëse janë respektuar procedurat për largim të përkohshëm nga puna i paditësit në bazë të vendimit nr. 01-../2018 i datës 06.04.2018 dhe ri sistemimi në një vend tjetër të punës në bazë të vendimit për ri sistemin nr. 01-... të datës 16.10.2018, e si rrjedhojë nëse paditësit i takon kompensimi për pjesën e pagave të pa paguara dhe diferencën e tyre dhe nëse largimi i përkohshëm dhe risistemimi ka ndodhë për shkak të neglizhencës së paditësit në punë apo procedurës penale.

Gjykata si fillim, duke u nisë nga faktet jo kontestuese e duke vijuar me ato kontestuese, ka ardhë në përfundim se pala e paditur, paditësit në mënyrë të kundërligjshme është suspenduar dhe ri sistemuar, e si rezultat i kësaj, vendimet e atakuara duhet të anulohen, kurse paditësit të i paguhen pjesa e pagave të pa paguara dhe dieferenca në mes të koeficienteve për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Edhe pse pala e paditur e ka kthyer paditësin në vendin e tij të punës, kurse vendimet e atakuara më nuk prodhojnë ndonjë efekt juridik, gjykata vlerëson se të njëjtat duhet të anulohen, sepse

ato kanë prodhuar efekt juridik për një kohë të caktuar, kurse anulimi i tyre ka efekt retroaktiv dhe paditësi mund të realizoj në këtë mënyrë të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës e që në mënyrë të kundërligjshme i janë mohuar. Në këtë aspekt, gjykata vlerëson se paditësi ka interes juridik në kërkesën e tij.

Përmes kontratës së punës për kohë të pacaktuar me numër .../2013 e dt. 20.03.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi I.H. me të paditurën Posta e Kosovës, kanë nënshkruar kontratë të punës, sipas të cilës paditësi kishte detyrat e punës Kontrollor i Z.P në Postën e Kosovës, në lokacionin Posta Pejë. Kjo kontratë sipas neni 3 të ka hyrë në fuqi nga data 01.03.2013 e me kohë të pa caktuar e ku paditësi kishte gradën 6. Në nenin 14 të kësaj kontratë janë paraparë rrethanat e ndërprerjes së marrëdhënies së punë.

Nga vendimi 01-.../2018 i datës 06.04.2018 mbi largimin e përkohshëm të punëtorit nga kompania e PK Sh.A, gjykata ka vërtetuar se punëtori I.H., kontrollor i zyrës postare Peja 01, në regjionin e Pejës në PK Sh.a, është larguar përkohësisht nga kompania e PK, duke filluar nga data 06.04.2018, bazuar në nenin 73 të Ligjit 03/L-212 i Punës dhe nenin 15 të Kodit të Mirësjelljes së punonjësve dhe proceduarave disiplinore të PK – Sh.a. Të njëjtit i ishte ndaluar qasja në objektet e PK Sh.a në cilësi të punësuarit e ku vendimi për largimin e përkohshëm do të zgjat deri në një vendim të ardhshëm, kurse përgjatë kësaj periudhe do të takojnë të ardhurat personale në lartësi të ½ të të ardhurave personale. Deri tek ky vendim, bazuar në arsyetimin e tij, ka ardhur pasi që në arkën në të cilën ka qenë përgjegjës paditësi dhe një person tjetër me emrin Q.A. kanë munguar të hollat në shumë prej 6,244.00 euro. Ishte bërë kërkesë që të kontrollohen kamerat pas orës 19:00, sepse kjo dyshohet të jetë periudha kur ka ndodhur vjedhja. Ky vendim ishte nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv dhe kishte këshillën juridike për komisionin për ankesa, kurse udhëzimin që i njëjti ti dorëzohet paditësit, kryeshefit ekzekutiv në PK sha, resurseve njerëzore, financave të PK sh.a, kontrolles së brendshme të PK sh.a, dhe arkivit.

Më tej, Drejtoria e Inspektorëve Postar, kishte përpiluar një raport inspektimi lidhur me mungesën e mjeteve financiare në arkës ZP Pejë 01 i datës 16.04.2018 me nr. protokollin 01-.../18, ku kishin konstatuar se kasaforta e ZP Pejë 01 (nga e cila janë vjedhur mjetet financiare), është e vendosur në zyrën e punës së përgjegjës komunal Q.A. dhe kontrollorit të ZP I.H. i cili njëkohësisht ka kryer dhe detyrat e arkëtarit, për shkak të pozitës vakante, ku qelësat për hapjen dhe mbylljen e kasafortës i kanë poseduar kontrolleri i ZP dhe Përgjegjësi Komunal. Tutje kanë konstatuar se përgjegjësia e drejtpërdrejt bie mbi kontrollorin e ZP dhe Përgjegjësin Komunal të



cilët nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme konform detyrave dhe përgjegjësi të tyre të punës, për sigurimin e kasafortës, përkatësisht zyrën në të cilën kanë punuar ara dhe ka qenë e vendosur kasaforta për ruajtjen e produkteve dhe mjeteve. Të njëjtit nuk kanë guxuar që të lejojnë qasje në këtë zyrë të asnjë punonjësi pa prezencën e tyre dhe vetëm zyrtarisht, në mënyrë që të parandalohet çdo keq përdorim i mundshëm. Si përgjegjës tjerë për humbjen/vjedhjen e mjeteve financiare në kasafortën e ZP në Pejë 01, kanë edhe Kontrolla Operative dhe Koordinatori Regjional, të cilët edhe pse kanë pasë dijeni për neglizhencën e vazhdueshme për të dy përgjegjësit, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për eliminim të parregullsive. Një raport i tillë, ta bashkangjitura kishte procesverbalin mbi gjendjen e arkës ku diferenca e paraqitur ka rezultuar të jetë -6,244.00 euro, gjendjen aktuale të arkës, barazimin e shitjeve ditore dhe shkarkesën me produkte për ndërrimin e parë dhe të dytë të datës 05.04.2017, librin e shitjes për të njëjtën datë, ngarkesat dhe raportin statistikor për asistencë sociale, vërejtjen me shkrim për I.H., deklaratat e I.H. etj dhe fotografitë e kasafortës nga e cila ka ndodhë vjedhja e mjeteve.

Paditësi, nga ajo që vërtetohet përmes Përgjigjes në ankesën e punëtorit I.H. e cila mban datën e përpilimit 20.04.2018 kurse datën e protokollit 25.04.2018 dhe numrin e protokollit 01./18, Posta e Kosovës, përkatësisht komisioni i ankesave në përbërje të tre anëtarëve nga të cilët njëri ka qenë kryetar, vërtetohet se e ka atakuar vendimin e krye shefit ekzekutiv me nr. 01-.../18 dt.06.04.2018, e me këtë rast ky komision, paditësi i ka kthyer përgjigje, ku ndër të tjera kanë cekur se komisioni ka shqyrtuar faktet dhe provat dhe ka vërtetuar vendimin mbi largimin e përkohshëm nga puna si të bazuar. E rëndësishme për tu theksuar në këtë përgjigje është se ky komision, ka kthyer këtë përgjigje për shkak se ndaj paditësit ishte paraqitur raport në komisionin disiplinor, për shkak të shkeljeve të kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore...duke konstatuar se i njëjti duhet të vazhdojë të jetë i larguar deri në ***përfundimin e hetimeve nga Policia e Kosovës*** si dhe shqyrtimit të rastit nga ana e Komisionit Disiplinor, si organ kompetent për paraqitje në komision disiplinor. Si përfundim, kjo përgjigje ishte nënshkruar nga ana e dy anëtarëve dhe kryesuesit të komisionit, pra gjithsej tre persona dhe kishte këshillën juridike për drejtim gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh.

Më pas, gjykata ka vërtetuar se e paditura ka vazhduar me procedurën disiplinore ku komisioni disiplinor i Postës së Kosovës Sh,a, në përbërje të kryetarit H.K. dhe anëtarëve A.I. dhe B.K., me vendimin e datës 24.05.2018 me numër protokollit 01-1.../18, të punësuarit I.H. ishte shpallë përgjegjës për shkak se me veprimet e tij kishte bërë shkelje të procedurave disiplinore të punës që kanë të bëjnë me nenin 14.1 pika (j,k,m,z) të Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve dhe

Procedurave Disiplinore, ashtu që komisioni kishte vendosë vazhdimin e masës largim i përkohshëm sipas vendimit nr. 01-...18 dt.06.04.2018 (që është vendimi i nxjerrë nga krye shefi ekzekutiv për largim të përkohshëm nga puna dhe i atakuar me padi) e cila periudhë do të zgjasë deri me dt. 05.10.2018, duke e rekomanduar RNJ-në, që punëtori në fjalë në momentin që kthehet në punë, të risistemohet/ ulet në pozitë ku do të ketë pagë dhe përgjegjësi më të vogël.

Më pas, paditësit përmes Vendimit mbi ri sistemimin e punëtorit me numër 01-.../18 i datës 16.10.2018, është bërë ri sistemimi nga vendi i punës që e kishte sipas kontratës, më parë paditësi si kontrollor i ZP-Pejë, në punëtorë sporteli-Regjioni Pejë e për periudhën nga dt. 06.10.2018 e deri me dt. 05.10.2019, me ç ‘rast paditësit i është ulur paga mujore në lartësi të gradës 5 e cili vendim është bërë pjesë e kontratës së punës 01-862/13 dt.20.03.2013, për çka paditësi ka ushtruar ankesë ndaj këtij vendimin brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 78 të Ligjit të Punës, e i cili fakt është vërtetuar përmes ankesës së paraqitur nga paditësi e që është administruar si provë, ankesë kjo e datës 26.10.2018.

Vendimeve dhe raporteve të marra nga e paditura, gjykata nuk u ka falë besimin, sepse të njëjtat për gjykatën janë të kundërligjshme dhe si të tilla duhet të anulohen, sepse nuk janë përfillur procedurat e para para me ligjin e punës dhe aktet e brendshme të palës së paditur.

Se ndaj paditësit I.H. ishte paraqitë kallëzim penal lidhur me rastin që kishte ndodhur për humbjen e parave, u vërtetuar përmes Aktvendimit me numër PP/II.nr.2.../2018 i dt.12.11.2018 i Prokurorisë Themelore në Pejë, e me të cilin ishte Hedhë kallëzimi penal me numër 2018 – DA-1098 i dt. 09.10.2018, për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 i KPRK-së, sepse në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i paraqituri ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet ose ndonjë vepër tjetër penale sipas detyrës zyrtare.

Aktvendimit në fjalë, gjykata i ka falur besimin, sepse i njëjti është marrë nga organi kompetent, në këtë rast Prokuroria Themelore në Pejë, e i cili gjykatës i ka shërbyer për të vërtetuar se ndaj paditësit nuk është zhvilluar më tej procedura penale, por kallëzimi penal është hedhë.

Më tutje, lidhur me këtë çështje ishte njoftuar dhe inspektorati i punës, ku përmes Raportit të Inspektoratit të punës i datës 18.12.2018 me numër 234, u vërtetua se inspektorati si institucion zyrtar shtetëror, kishte konstatuar gjetjet e tyre lidhur me ankesën e paraqitur nga paditësi si dhe personi tjetër me emrin Q.A. që ka qenë i përfshirë në këtë rast. Në mes tjerash, sipas

inspektorëve të punës janë bërë disa lëshime nga ana e të paditurës gjatë procedurës disiplinore të zhvilluar dhe organeve të cilat i kanë nxjerrë këto vendime e të cilat më pas janë atakuar në procedurë gjyqësore.

Këtij raporti, gjykata nuk i ka falur besimin sepse i njëjti është nuk është nxjerrë ne bazë të kompetencave që ka inspektorati i punës, sepse ka dhënë konstatime mbi vendimet që janë objekt i shqyrtimit, e për të cilat në fakt kompetent është gjykata e jo inspektorati i punës, pra inspektorati i ka tejkaluar kompetencat e tij që i ka të përcaktuar me Ligjin për inspektoratin dhe Ligjin e Punës.

Lidhur me lartësinë e kontestit, gjykata si provë materiale ka administruar, të dhënat për koeficientin 5 dhe 6 për paditësin I.H. dhe ekspertizën financiare të ekspertit Gani Gashi e dt. 11.09.2019. Nga të dhënat për koeficientin për paditësin, gjykata ka vërtetuar se nga muaji 4 e deri në muajin 10 të vitit 2018, paditësi kishte koeficientin 6, kurse nga muaji 11 e deri në muajin 7 të vitit 2019, paditësi kishte koeficientin 5. Tutje, sa i përket ekspertizës financiare, është provuar se paditësit në emër të kompensimit të 50 % të pagave të pa paguara nga data 06.04.2018 e deri me datën 16.10.2018 nuk i janë paguar dhe atë: në emër të diferencës së pagës neto prej 1,901.37 euro, në emër të kontributeve për trustin pensional në shumë totale prej: 222.38 euro, ku 111,19 euro paguhen si kontribut i punëdhënësit (paditurit) të llogaritur 5%, kurse 111,19 euro paguhen si kontribut i punëmarrësit (paditësit) e të cilat paguhen në llogarinë e paditësit në Trustin Pensional – Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në emër të tatimit në pagë në shumë: 211,26 euro të cilat paguhen si tatim në burim në ATK, me kamatë të llogaritur nga data 01.05.2018 e deri me datën 10.09.2018 në shumën prej 171,39 euro, dhe në emër të diferencës në mes të gradës 6 dhe 5 për periudhën nga data 06.10.2018 e deri me datën 05.10.2019 në lartësi të pagës neto prej 777,96 euro, në emër të kontributeve për trustin pensional në shumë totale prej: 90,98 euro, ku 45,49 euro paguhen si kontribut i punëdhënësit (paditurit) të llogaritur 5%, kurse 45,49 euro paguhen si kontribut i punëmarrësit (paditësit) e të cilat paguhen në llogarinë e paditësit në Trustin Pensional – Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në emër të tatimit në pagë në shumë: 86,44 euro të cilat paguhen si tatim në burim në ATK, me kamatë të llogaritur nga data 01.11.2018 e deri me datën 10.09.2019 në shumën prej 26,33 euro. Pra përmes kësaj eksperitze është vërtetuar se paditësi kishte pagën bruto në lartësi prej 741.22 euro, kurse diferenca në mes të koeficientëve 6 dhe 5 ishte në shumë prej 81.46 euro.

Gjykata në shqyrtimin paraprak kishte ftuar për sqarime ekspertin financiar i cili kishte deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës së përpiluar, kurse sa i përket çështjes se është deklaruar se

paditësit duhet ti paguhen këto shuma, ka cekur se ky është një gabim në shprehje nga ana e tij, sepse gjykata vendosë lidhur me kërkesën.

Ekspertizës së ekspertit, gjykata i ka falur besimin në tërësi, pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale nga ana e ekspertit.

Në shqyrtimin paraprak, në cilësi të palës është dëgjuar edhe paditësi I.H., i cili në seancën e datës 16.07.2019 ka deklaruar se është punëtor i postës që nga viti 2009 ku fillimisht ka punuar si punëtor sporteli, kurse nga viti 2011 ka kaluar në cilësinë e kontrollorit të zyrës postare të regjionit të Pejës – Peja 1, e të cilën pozitë e ka pas deri kur ka ndodhur rasti objekt kontesti. Me datën 05.04.2018, bashkë me kolegun e tij Q.A., posa ka hyrë në zyrë kanë vërejtur mungesën e parave në shumë prej 6,240 euro, ku e kanë njoftuar menaxherin dhe policinë e Kosovës. Më pas lidhur me këtë rast është suspenduar nga puna, kurse ka dhënë edhe intervistë në policinë e Kosovës, e në ndërkohë ka marrë edhe vendimin se kallzëimi penal ndaj tij është hedhë. Lidhur me qelsat e kasafortës ka deklaruar se të njëjtit i ka pasë personalisht paditësi por edhe Q.. Pasi që ka ndodhur rasti, kanë kërkuar që të kontrollohen kamerat e sigurisë, por përgjigja ka qenë se kjo do kohë që të ndodhë. Sa i përket zyrës së ku ka punuar së bashku me Q., ajo ka qenë shumë e dobët dhe mund të thuhet in ekzistente. Pjesa tjetër e deklaratës së paditësit ka pasë të bëjë në tërësi me rastin e ndodhur dhe përkrahimin e ngjarjes.

Gjykata deklaratës së paditësit nuk i ka falur besimin, sepse ajo në tërësi ka qenë subjektive, por edhe nga fakti tjetër se përmes kësaj deklarate nuk është se mund të provohet ndonjë fakt vendimtar, ngase kontestuese ka qenë procedura disiplinore që është ndjekur, përkatësisht nëse është respektuar si dhe nëse ka pasë neglizhencë të paditësit.

Fillimisht, gjykata thekson se në këtë çështje si ligj i aplikueshëm është Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, i cili është në fuqi nga data 16.12.2010. Sipas këtij ligji, konkretisht nenit 78 par. 1. *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura, par.2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Par. 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”.*

Me neni 79 të Ligjit të Punës, është paraparë mundësia e të punësuarit që të atakojë vendimin përfundimtar në gjykatë “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”.

Nga ajo që është provuar gjatë këtij shqyrtimit, gjykata ka ardhë në përfundim se deri tek largimi i përkohshëm i paditësit nga puna dhe ri sistemimi i tij në një pozitë tjetër, ka ardhur si rezultat i mungesës së mjeteve monetare në arkën e postës regjionale në Pejë ku ndaj të njëjtit është paraqitë kallëzim penal. Për këtë qëllim, është marrë vendimi i atakuar i cili nga krye shefi ekzekutiv, e ku më pas ka pasuar edhe vendimi i komisionit disiplinor si dhe krejt në fund edhe vendimi për ri sistemim të punëtorit (paditësit), e që pas kësaj nga pohimet e palëve në procedurë, paditësi është kthyer në vendin e tij të punës që kishte të lidhur me kontratën fillestare.

Pra, këto konkludime, gjykata i ka nxjerrë dhe provuar me provat të cilat i ka administruar e që janë elaboruar si më lartë, mirëpo e rëndësishme në këtë situatë është të sqarohen disa fakte.

Vendimi mbi largimin e përkohshëm nga puna të paditësit i marrë nga krye shefi ekzekutiv, ku së pari gjykata sqaron për palët se bazuar në nenin 18.8 të kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore nr, 01-1...17 dt. 25.05.2017 i Postës së Kosovës Sh.a, krye shefi ekzekutiv mund të marrë vendim për suspendimin e punëtorit, në rastet kur qëndrimi i mëtutjeshëm i punëtorit në ndërmarrje e dëmton imazhin e ndërmarrjes, e i cili vendim i përcillet edhe komisionit disiplinor. Krye shefi ekzekutiv, me këtë rast ka marrë këtë vendim për largim të përkohshëm nga puna të paditësit me datën 06.04.2018, por që vendimin e tij, nuk e ka përcjellë tek komisioni disiplinor, fakt ky që vërtetohet nga vendimi në fjalë, në pjesën e fundit të vendimit, pra tek pjesa e subjekteve që duhet të i dorëzohet vendimi. Pra, krye shefi ekzekutiv me këtë rast ka bërë shkelje kur vendimin e tij të marrë, nuk e ka dorëzuar në komision disiplinor sipas obligimit të tij, me qëllim që më pas në raport me paditësin të zhvillohen procedurat disiplinore.

Në bazë të fakteve të prezantuara dhe provave me të cilat janë vërtetuar këto fakte, gjykata konstaton se deri tek largimi i përkohshëm i punëtorit nga vendi i punës me 50 % të pagës, ka ardhë për shkak të humbjes së parave në arkën në të cilën sipas të paditurës kanë qenë përgjegjës paditësi dhe personi tjetër Q.A..

Në lidhmëni me këtë vendim, më pas Drejtoria e Inspektorëve PK sh.a, ka iniciuar dhe procedurën disiplinore ndaj paditësit, e për shkak të mungesës së mjeteve financiare, përkatësisht vjedhjes së mjeteve mes datave 05/06.04.2018 nga punonjës të pa identifikuar. Më pas ka pasuar vendimi i komisionit lidhur me këtë kërkesë, që është vazhduar masa e largimit të përkohshëm, me rekomandim që pasi të kthehet në punë, të risistemohet në pozitë më të ulët. Krejt në fund, paditësi me vendim të krye shefit ekzekutiv, është sistemuar në një pozitë më të ulët nga data 06.10.2018 e deri me dt.05.10.2018. Pra e tërë kjo procedurë ndaj paditësit është zhvilluar për shkak të humbjes/ vjedhjes së parave në arkë.

Gjykata lidhur me këtë procedurë, konstaton se largimi i përkohshëm i punëtorit, ka ardhur si rezultat i humbjes së parave dhe procedurës penale, mirëpo vendimi i krye shefit ekzekutiv me të cilin punëtori është larguar përkohësisht, nuk përmban asnjë nga shkeljes për të cilat punëtori në fjalë është larguar nga puna, ashtu siç përcaktohet me nenin 14 të kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore nr, 01-.../17 dt. 25.05.2017 i Postës së Kosovës Sh.a. Si rrjedhojë, vendimi i krye shefit ekzekutiv është i kundërligjshëm.

Lidhur me ligjshmërinë e vendimit të komisionit disiplinor, gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e të njëjtit, pasi që nuk ka qenë objekt i shqyrtimit me kërkesëpadi.

Sa i përket vendimit mbi ri sistemimin e paditësit në një pozitë tjetër, gjykata në këtë rast konstaton se ky vendim është i kundërligjshëm sepse është marrë nga krye shefi ekzekutiv, sepse sipas nenit 17 kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore nr, 01-1...17 dt. 25.05.2017 i Postës së Kosovës Sh.a., përgjegjës për shqiptimin e kësaj mase disiplinore për degradim sipas rregullores së kategorizimit të gradave në PK sh,a, është Përgjegjësi e komisionit disiplinor e jo e krye shefit ekzekutiv.

Bazuar në nenin 17 par.4, masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale, ku masa që i është shqiptuar paditësit është e paraparë në pikën f) të këtij kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore, e cila në fakt bazuar në nenin 17.7 shqiptohen për shkeljet e rënda e që janë paraparë me nenin 14 të të njëjtit kod. Pra para, përveç se këtë masë e ka shqiptuar personi i pa autorizuar, nuk është respektuar as rendi i masave dhe mënyra e shqiptimit të tyre, pasi që vet e paditura me rregullore e ka paraparë mënyrën e shqiptimit të tyre, duke filluar nga ajo më e lehta e deri tek masa më e rëndë.

Pavarësisht këtyre të cekurave më lartë, edhe sikur procedura disiplinore për largimin e përkohshëm të paditësit nga puna si dhe sistemimin e tij në një pozitë tjetër, gjykata konstaton se pasi që ndaj të njëjtit është bërë edhe kallëzim penal, e i cili është hedhë me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Pejë, atëherë bazuar në nenin 10.4 pika b) i kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore nr, 01-1.../17 dt. 25.05.2017 i Postës së Kosovës Sh.a., ku përcaktohet se “ asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër punonjësit të PK sh.a. më pas shpalljes i/e pafajshëm/e, ose përjashtimisht nga një procedurë penale. Pra në rastin konkret kundër paditësit nuk është marrë fare aktvendimi për fillim të hetimit për humbjen e parave por që kallëzimi penal është hedhë, e që i njëjti nuk mund të privohet nga të drejtat të cilat i takojnë.

Sipas nenit 10 të kodit të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore nr, 01-1.../17 dt. 25.05.2017 i Postës së Kosovës Sh.a., “punonjësit e PK do të iu nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrave të punës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, e siç është përcaktuar me këtë kod. Pra është më se e qartë se nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi objektive të punëtorit, por me përgjegjësi sipas fajit, e që në rastin konkret fajësia provohet në procedurë penale, e që paditësi nuk është shpallur fajtor.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarit të palës së paditur lidhur me përgjegjësinë disiplinore të paditësit, mirëpo pretendimet e tilla kanë qenë të pa bazuara, sepse vendimet e marra në procedurë, janë marrë kundërligjshëm dhe duke mos respektuar aktet e brendshme të vetë kompanisë (palës së paditur) kurse në këtë rast edhe pse procedura disiplinore është iniciuar për shkak të humbjes së parave, në kuptim të nenit 10 të kodit të sipër cituar, punëtorët do të iu nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrave të punës e që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, e që i bie që në këtë rast nuk është provuar se paditësi ka pas faj lidhur me humbjen e mjeteve monetare.

Sa i përket lartësisë së kontestit, me të cilën gjykata ka aprovuar tërësisht kërkesëpadinë e paditësit, ka vepruar në këtë mënyrë duke u bazuar në nenin 80 të Ligjit të Punës e lidhur me nenin 55 dhe 73 të po të njëjtit ligj. Gjykata në interpretim të këtij neni sqaron, se kjo dispozitë ligjore, është dispozitë autorizuese për gjykatën, kur e njëjta gjen se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme. Bazuar në këtë nen, gjykata ka gjetur se largimi i përkohshëm i paditësit është bërë në mënyrë të kundërligjshme, andaj palës së paditur i bie barra e kompensimit për paditësit, për largimin e përkohshëm nga puna sepse i njëjti nuk është gjetur fajtor, dhe kur shikohet në lidhmëni me nenin 73 të Ligjit të Punës, i punësuari mund të

largohet përkohësisht nga puna kur “ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale, i punësuari është në vuajtje të paraburgimit; kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj. Pikërisht vendimi për largim të përkohshëm është bërë mbi këtë bazë ligjore, me çka kuptohet se kjo nuk ka pasur të bëjë me neglizhencë të paditësit por për dyshim të kryerjes së veprës penale, për çka edhe është paraqitë kallëzim penal kundër paditësit.

Sa i përket fakteve vendimtare në këtë procedurë, janë paraqitur nëse vendimi mbi largim të përkohshëm nga puna për paditësin dhe vendimi mbi ri sistemimin dhe uljes të gradës për pagë janë të kundërligjshëm apo jo e që përmes provave materiale u vërtetua se këto vendime janë nxjerrë kundërligjshëm, kurse lartësia e kontestit është vërtetuar përmes ekspertizës financiare.

Duke ju referuar dispozitës së nenit: 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata ka vlerësuar dhe provat e tjera materiale të cilat janë administruar, mirëpo ato nuk kanë paraqitur ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës.

Gjykata vendimin lidhur me kamatën e gjykuar e mbështet në dispozitat e nenit 382 par.1 të LMD- se “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, duke ia njohur paditëses kamatën vjetore prej 8% sipas nenit 382 të LMD-së “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, sipas kërkesës së saj e vetëm sa i përket kryegjësë, e të cilat vetëm sa kanë arritur për pagesë deri në përpilim të ekspertizës, kurse pjesa tjetër që nuk ka arritur për pagesë, pas përpilimit të ekspertizës e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur komfor nenin 452.1 të LPK-it së, me çka e ka detyruar të paditurën që paditëses t’ia paguan shpenzimet e procedurës dhe atë për padi shumë prej 104 euro, për 6 seanca të mbajtura nga 135 euro për seancë, taksën për padi në shumë prej 40 euro, për ekspertizë financiare në lartësi prej 100 euro, e në total në shumë prej 1,054 euro, të llogaritur sipas tarifës së OAK për vlerën e kontestit deri në 10,000 euro, kurse



dy seanca të tjera që janë kërkuar shpenzimet nuk janë mbajtur.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:092506, C.nr.445/24, Dt.30.04.2024

Gjyqtari  
Vegim Maloku

---

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.